



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 362/2015

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.06.2015 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizimin e vlerësimit teknik të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe shpalljen si oferta më e mirë e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “InfraTransProject” sh.p.k & “S.D.C” sh.p.k & “Hazbiu Projekt” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence” me objekt: “Shërbime projektimi dhe mbikqyrje punimesh për projekte të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve”, me fond limit 20.833.333 lekë (pa TVSH), faza e parë e të cilit është zhvilluar në datën 20.03.2015, nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.”

Ankimues:

“InfraTransProject” sh.p.k
Rr. “Qemal Stafa”, Pall. 132, K.2, Ap.1
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të

Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*".

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.03.2015 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit "*Shërbim konsulence*" me objekt: "*Shërbime projektimi dhe mbikqyrje punimesh për projekte të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve*", me fond limit 20.833.333 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 20.03.2015 është zhvilluar faza e parë e procedurës së prokurimit. Në këtë fazë morën pjesë operatorë ekonomikë të mëposhtëm;

- | | |
|--|----------------|
| 1. Atelier 4 | kualifikohet |
| 2. Klodioda | kualifikohet |
| 3. InfraTransportProjekt &“SDC” & Hazbiu Project | kualifikohet |
| 4. Gjeokonsult | kualifikohet |
| 5. C.E.C & Erald-G | kualifikohet |
| 6. Ave Consulting & D&Cpartners | s’kualifikohet |
| 7. Ersi-M & Ilira | s’kualifikohet |

II.3. Në datën 08.05.2015 është zhvilluar faza e dytë e procedurës së prokurimit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranoi zarfat me propozimin teknik dhe ekonomik të ofertuesve të kualifikuar. Nuk janë paraqitur në orën dhe në datën e përcaktuar për hapjen e propozimeve teknike operatorët “Klodioda” sh.p.k dhe “Gjeokonsult” sh.p.k.

II.4. Në datën 13.05.2015 KVO-ja përfundoi vlerësimin e ofertave teknike të ofertuesve të kualifikuar dhe u bëri të njohur rezultatet ofertuesve pjesëmarrës, si më poshtë:

- | | |
|--|-------------|
| 1. Atelier 4 | 68.84 pikë |
| 2. C.E.C & Erald-G | 74.72 pikë |
| 3. InfraTransportProjekt &“SDC” & Hazbiu Project | 68.632 pikë |

Sipas proces verbalit të vlerësimit të propozimeve teknike datë 12.05.2015, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bëri shqyrtimin e propozimeve teknike, duke dhënë vlerësimin me pikë si më poshtë:

<i>Kriteri i vlerësimit</i>	<i>Atelier 4 sh.p.k</i>	<i>C.E.C-11 & Erald-G</i>	<i>InfraTransportProjekt &“SDC” & Hazbiu Project</i>
<i>Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit 0-10 pikë</i>	6.82	10	4.09
<i>Metodologjia e propozuar 20-50 pikë</i>	45	45	45
<i>Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar 0-30 pikë</i>	24.23	28.4	26.7
<i>Transferimi i njohurive 0-10 pikë</i>	10	10	10
<i>Shuma pikë</i>	86.05	93.4	85.79
<i>Pesha për anën teknike</i>	68.84	74.72	68.632

II.5. Në datën 19.05.2015 operatori ekonomik ankimes “InfraTransportProject” sh.p.k si përfaqësues i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “InfraTransportProject” & “SDC” & “Hazbiu Project” ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vlerësimin teknik të KVO-së. Konkretisht pretendohet si vijon:

1. *Vlerësimi i bërë nga KVO-ja në rubrikën “Përvoja me punë të ngjashme” është i padrejtë. Shoqëritë “InfraTransportProject” & “SDC” & “Hazbiu Project” janë nga shoqëritë më të vjetra në tregun e konsulencës që operon në fushën e studimit, projektimit dhe mbikqyrjes së punëve për infrastrukturë dhe urbanizëm në Republikën e Shqipërisë. Janë themeluar respektivisht në vitet 1995 dhe SDC që në 1994, ndërsa “Hazbiu Project”, fillimisht si person fizik në 1992 dhe më pas në 2003 dhe rirregjistruar në 2009 si kompani. Të gjithë këta subjekte, që nga fillimi i aktivitetit e deri më sot, kanë operuar vetëm në fushën e projektimit dhe mbikqyrjes së punimeve të infrastrukturave në mënyrë të pandërprerë. Gjatë kësaj periudhe janë projektuar si kompani mbi 2000 km rrugë automobilistike të kategorive të ndryshme teknike, nga rrugë rurale deri tek autostradat më të rëndësishme (ndërsa si specialitete të vecanta, dy nga projektuesit kryesore kanë një shifër të jashtëzakonshme prej mbi 4500 km rrugë të të gjitha kategorive dhe llojeve nga më të vështirat teknikisht deri tek më të thjeshtat).*

Duke patur parasysh kërkesat tuaja si kërkesë e vecanta në dokumentat e tenderit, fq 36, ku kërkohen struktura, strukturat e transportit, vepra inxhinierike dhe po aty “...mund të kërkohen shërbime shtesë” ku specifikohen ...studime të ndikimit në mjedis, shërbime që i takojnë nëntokës dhe punimeve në themele, mund të themi se struktura dhe konstruksione të vecanta, janë projektuar me qindra ura dhe viadukte të vështirësive nga më të lartat, dhjetra viadukte (madje edhe në zona sizmike), ku janë bërë për herë të parë edhe llogaritjet antisizmike, veprat e artit dhe ura të vështira të klasit ndërkombëtar si ura të tipit “Kantilever”, të projektuara për herë të parë në vendin tonë. Janë hartuar për herë të parë projektet e strukturave nga më të vështirat në vendin tonë dhe në inxhinieri siç janë, tunelet me teknologjitë bashkëkohore (jemi e vetmja kompani), shkarje të vështirësive shumë të larta inxhinierike, mbrojtje lumejsh dhe në Hidrocentrale (HC Fierzë), dysHEME rrugore dhe aeroportuale të vështirësive të larta etj. Është projektuar dhe mbikqyrur i vetmi Aeroport i projektuar në vendin tonë, i cili përfshin dysHEME dhe rrugë, drenazhime e ujësjellës, ndërtesa (arkitekture) dhe sisteme sheshe e parkinge, të gjitha të vështirësisë së lartë teknike. Rreth 80% e veprave të lartpërmendura janë prokuruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, sot Autoriteti Rrugor Shqiptar, ku dy nga tre kompanitë tona janë konsulentët më të mëdhenj, më të vjetër dhe me punët më të vështira dhe më të rëndësishme.

Vetëm vitin e kaluar janë kryer tre projekte të planeve vendore dhe janë fituar gara me konkurs, madje edhe me konkurs ndërkombëtar siç janë ndërtesa e Parlamentit dhe Konkursi i fituar i Planit Urbanistik të qytetit të Sarandës. Janë projektuar me qindra kilometra rrugë urbane (Tiranë, Durrës, Vorë, Berat, Sarandë, Elbasan, Shkodër, Lezhë etj), të cilat janë shoqëruar me projekte të detajuara në ndriçim,

kanalizim-ujësjellës dhe gjelbërim. Këto elementë projektimi janë të ngjashëm edhe në projekte si Dogana (tre dogana dhe një aeroport), ku përvec ndricim, kanalizim-ujësjellës, parking dhe gjelbërim, përfshin edhe arkitektura e tyre dhe më tej edhe mbikqyrja e punimeve. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre projekteve kanë qënë paraprirës edhe me studime fizibiliteti për klientë lokale dhe ndërkombëtare (STRABAG, KE, BB etj.,) ku përfshihen edhe studime nga më të arrirat të Mjedisit (kërkuar edhe këto në dokumentat e tenderit) sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe Standardeve të pranuar Ndërkombëtare të Bankës Botërore dhe KE-së. Përsa më sipër, grupimi jonë posedon vërtetimet përkatëse të punimeve të realizuara dhe dokumentacionet përkatëse që gjenden pranë klientëve respektive. Në këto kushte kërkohet [...] rivlerësimin e pikëve në favor të shoqërisë “InfraTransportProject” & “SDC” & “Hazbiu Project”.

2. Vlerësimi i bërë nga ana e KVO-së në rubrikën “Kualifikimi i stafit kryesor të propozuar” është i padrejtë. Në listën e stafit, që shoqëritë “InfraTransportProject” & “SDC” & “Hazbiu Project” kanë përfshirë për realizimin e objektit të prokurimit, janë ekspertët më me eksperiencë që ka sot në Shqipëri, si në drejtim të vjetërsisë në punë si inxhinierë ashtu edhe si ekspertë të fushave specifike. Aktiviteti i tyre në specialitetet përkatëse fillon me Institutin Shtetëror të Projektimit, që para viteve “90”. Mesatarja e eksperiencës në specialitetet përkatëse është 42 vjet. Në tre specialitetet kryesore që kërkohen në projektimin e një rruge janë përfshirë:
- projektues rruge 46 vjet ekperiencë dhe inxhinieri i dytë 38 vjet ekperiencë e pandërprerë në këtë fushë projektimi. Të dy sëbashku kanë projektuar më shumë se 75% të të gjithë rrugëve të Shqipërisë, të projektuara në 50 vitet e fundit.
 - Projektues struktur/vepra arti 4 dhe 46 vjet eksperiencë të padërprerë në këtë fushë.
 - Arkitekt Urbanist me 36 vjet ekperiencë.
 - Inxhinier gjeolog 50 vjet eksperiencë të pandërprerë në këtë fushë.
 - Inxhieri gjeodet 51 dhe 31 vjet eksperiencë
 - Inxhinieri elektrik , 46 vjet eksperiencë.
- Mesatarja e eksperiencës së stafit të deklaruar: 42.1 vjet.

II.6. Në datën 22.05.2015 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën. Në përgjigjen e autoritetit kontraktor jepen argumentat si vijon:

“[...] Nga dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesit në këtë procedurë prokurimi del qartë eksperiencia e madhe dhe cilësia e punës me të cilën operon secili nga pjesëmarrësit në procedurën e lartpërmendur.


Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë “InfraTransportProject” & “SDC” & “Hazbiu Project” e vërteton këtë eksperiencë dhe cilësi jo vetëm me listën e projekteve të realizuara dhe punëve të kryera por edhe me stafin e paraqitur, staf i cili përbëhet nga inxhinierë dhe arkitektë me eksperiencë shumë vjeçare dhe që ka arritur të përfundojë me sukses projekte të rëndësishme dhe shumë të mëdha.

Eksperienca dhe përvoja e secilit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë del qartë nga interpretimi i dokumentacionit të paraqitur.

Megjithatë procedura e vlerësimit bazohet jo vetëm në interpretimin e dokumentacionit të paraqitur por edhe në atë çfarë ka dorëzuar dhe në përmbajtjen e këtij dokumentacioni, përmbajtje e cila nuk merret e vlerësuar veçmas nga përmbajtja e dokumentacionit të operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës. Pra kemi një vlerësim dhe një pikëzim jo të veçuar dhe absolut por relativ, të lidhur ngushtë dhe të bazuar në çfarë kanë dorëzuar operatorët e tjerë ekonomikë. Pra është marrë parasysh jo vetëm interpretimi i dokumentacionit por edhe korelacioni ndërmjet përmbajtjes së dosjeve nga secili prej operatorëve [...].

II.7. Në datën 27.05.2015 operatori ekonomik ankimues “InfraTransportProject” sh.p.k si përfaqësues i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “InfraTransportProject” & “SDC” & “Hazbiu Project” ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.8. Në datën 01.06.2015 dhe 02.06.2015 janë protokolluar në Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 982/2 prot e nr. 982/3 prot., shkresat e autoritetit kontraktor nr. 1142/1 prot., datë 29.05.2015; nr.1150 prot., datë 02.06.2015 me objekt: “Dërgim dokumentacioni”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.



III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankesë si dhe dokumentave e informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit përse i përket vlerësimit teknik të bërë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Sipas dokumentantave të tenderit, të publikuara në sistemin elektronik të prokurimeve, lidhur me fazën e dytë të zhvillimit të procedurës së mësipërme të prokurimit, “Vlerësimi i Propozimeve teknike”, përcaktohet se: *Autoriteti Kontraktor shqyrton çdo propozim teknik për të konfirmuar nëse ai është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në Dokumentat e Tenderit dhe se i pranon të gjitha afatet e kushtet. Propozimi që nuk plotëson Termat e References, ose dështon në pajtueshmërinë e kushteve dhe afateve të kontratës, të shprehura në Dokumentat e Tenderit, do të refuzohet. Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe rendit propozimet teknike në pajtim me procedurat dhe kriteret e vlerësimit të paraqitura në Dokumentat e Tenderit. Asnjë kriter vlerësimi nuk do të përdoret, nëse nuk është paraqitur në Dokumentat e Tenderit. Nëse Dokumentat e Tenderit parashikojnë një*

rezultat minimal që duhet të arrihet, çdo propozim që nuk arrin këtë minimum do të refuzohet.”

III.1.2. Në procedurën e mësipërme të prokurimit, kriteret e vlerësimit janë përcaktuar si më poshtë:

<i>Kriteret e Vlerësimit</i>	<i>Pikët</i>
(i) <i>Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit</i>	<i>[0-10]</i>
(ii) <i>Metodologjia e Propozuar</i> <i>(Përfaqja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)</i>	<i>[20-50]</i>
(iii) <i>Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar</i>	<i>[0-30]</i>
(iv) <i>Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet)</i>	<i>[0-10]</i>

Transferimi i njohurive nuk do të kërkohet. Pikët nga 0-10 ndahen përpjestimisht kritereve të tjera të sipercituara.

Total (Propozimi Teknik) 100%

- *Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.*

III.1.3. Ndërsa, në kriteret e vecanta të kualifikimit, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar përmbushja e kushteve si vijon:

Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin kontrata shërbimesh për projektim dhe mbikqyrje projektesh në zona urbane (psh sheshe, rruge urbane, godina, etj.), rruge të tjera, në vlerë totale prej 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit. Në rastin e bashkimit të Operatoreve Ekonomike, kontratat mund të paraqiten nga të gjithë partnerët në bashkim sipas specialiteteve dhe eksperiencave të tyre përkatëse. Kjo duhet të vërtetohet me dëshmi/çertifikata dhe dokumente për realizimin e tyre.

• *Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin një listë të stafit kryesor të mëposhtem, të cilët duhet të kenë një marrëdhënie kontraktore me operatorin apo partnerët në rastin e një bashkimi operatorësh. I gjithë stafi kryesor i kërkuar duhet të jetë i licënsuar në shërbimet e projektimit dhe mbikqyrjes dhe duhet të zotërojë licënsat profesionale të kategorive të kerkuara për Operatorin Ekonomik, si dhe kategoritë e renditura më poshtë, përkatësisht për specialitetin që mbulojnë. Për çdo pozicion, operatorët janë të lire të propozojnë me shumë se një kandidat, me qëllim përmbushjen e kritereve të kerkuara.*

Pozicionet e stafit kryesor të kerkuar janë:

Stafi për shërbimin e projektimit dhe mbikqyrjes

a. Drejtues Projekti (Drejtues i grupit të projektimit dhe ose grupit të mbikqyrjes) –

Inxhinier Ndërtimi/Arkitekt (sipas llojit të objektit)

b. Inxhinier Gjeolog

c. Inxhinier Arkitekt/Urbanist

d. Inxhinier Konstruktor

e. Inxhinier Elektrik

f. Inxhinier Topograf

• *Liçensat e tjera qe duhet te zoteroje stafi kryesor:*

Kategorite e Liçensave te kerkuara ne projektim: 2/c; 4/c; 8/a; 8/b; 9/a.

Kategorite e Liçensave te kerkuara ne mbikqyrje punimesh: NP-12, NS-14 dhe NS-18.

III.1.4. Nga shqyrtimi i ofertave operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në fazën e dytë të procedurës së prokurimit, rezulton se në lidhje me eksperiencat e mëparshme këto shoqëri kanë paraqitur dokumentacion të konsiderueshëm për kontrata në përgatitjen e masterplaneve dhe projekteve për rikualifikim të zonave urbane dhe të gjelbëra, si dhe projekte parqesh në të cilët evidentohet realizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme me kontratën objekt prokurimi.

Gjithashtu, rezulton se është paraqitur dokumentacion në lidhje me stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, duke e shoqëruar me CV.

III.1.5. Në nenin 3, pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, është përcaktuar se: “Kontratat e konsulencës” janë kontratat për shërbime publike konsulence, të një natyre intelektuale dhe këshilluese, duke përjashtuar llojet e tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë.

III.1.6. Sipas proces verbalit të punës së KVO-së, të datës 12.05.2015, gjykimi për vlerësimin me pikë të konsulentëve është marrë bazuar në argumentat e mëposhtme:

Operatori ekonomik “Atelier-4” sh.p.k:

Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit

Kjo shoqëri ka paraqitur në dokumentacionin e saj më shumë se 15 kontrata në përgatitjen e masterplaneve dhe projekteve për rikualifikim të zonave urbane dhe të gjelbëra, si dhe projekte parqesh. Komisioni, duke parë punët e kryera të konsulentit, numrin si dhe vlerat e tyre, vendosi ta vlerësojë këtë shoqëri, për këtë kriter, me 6.82 pikë nga 10 të mundshme.

Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar

Ofertuesi ka paraqitur stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, duke e shoqëruar me CV. Në stafin e paraqitur është Drejtuesi Teknik, Arkitekti, Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Konstruktor, Inxhinier Mekanik si dhe Inxhinier Elektrik.

Duke vlerësuar përvojën, eksperiencën si dhe vjetërsinë në punë të secilit prej tyre, Komisioni vendosi ta vlerësojë këtë shoqëri, për këtë kriter, me 23.24 pikë nga 30 pikë të mundshme.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “C.E.C” sh.p.k & “Erald-G” sh.p.k

Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit

Kjo shoqëri ka paraqitur në dokumentacionin e saj më shumë se 22 kontrata në përgatitjen e masterplaneve dhe projekteve për rikualifikim të zonave urbane dhe të gjelbëra, si dhe projekte parqesh. Komisioni, duke parë punët e kryera të konsulentit, numrin si dhe vlerat e tyre, vendosi ta vlerësojë këtë shoqëri, për këtë kriter, me 10 pikë nga 10 të mundshme.

Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar

Ofertuesi ka paraqitur stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, duke e shoqëruar me CV. Në stafin e paraqitur është Drejtuesi Teknik, Arkitekti, Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Konstruktor, Inxhinier Mekanik si dhe Inxhinier Elektrik.

Duke vlerësuar përvojën, eksperiencën si dhe vjetërsinë në punë të secilit prej tyre, Komisioni vendosi ta vlerësojë këtë shoqëri, për këtë kriter , me 28.4 pikë nga 30 pikë të mundshme.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “InfraTransportProject” sh.p.k & “SDC” sh.p.k & “Hazbiu Project” sh.p.k.

Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit

Kjo shoqëri ka paraqitur në dokumentacionin e saj 9 kontrata në përgatitjen e masterplaneve dhe projekteve për rikualifikim të zonave urbane dhe të gjelbëra, si dhe projekte parqesh. Komisioni, duke parë punët e kryera të konsulentit, numrin si dhe vlerat e tyre, vendosi ta vlerësojë këtë shoqëri, për këtë kriter, me 4.09 pikë nga 10 të mundshme.

Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

Ofertuesi ka paraqitur stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, duke e shoqëruar me CV. Në stafin e paraqitur është Drejtuesi Teknik, Arkitekti, Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Konstruktore, Inxhinier Mekanik si dhe Inxhinier Elektrik.

Duke vlerësuar përvojën, eksperiencën si dhe vjetërsinë në punë të secilit prej tyre, Komisioni vendosi ta vlerësojë këtë shoqëri, për këtë kriter, me 26.7 pikë nga 30 pikë të mundshme.

III.1.6. Lidhur me sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se vlerësimi i propozimit teknik të çdo operatori ekonomik në fazën e dytë të procedurës së prokurimit i nënshtrohet procesit të pikëzimit në lidhje me disa elementë si: përvoja e konsulentit; cilësia e metodologjisë së propozuar; kualifikimet e stafit kryesor të propozuar; transferimi i njohurive nëse kërkohet. Sasia dhe fletët e materialit të dorëzuar jo detyrimisht lidhen dhe me cilësinë e propozimit teknik, përfshirë këtu metodologjinë, përvojën, kualifikimet e stafit kryesor apo kërkesa të tjera të përcaktuara nga AK.

Ashtu siç sqaron edhe autoriteti kontraktor, procedura e vlerësimit bazohet jo vetëm në interpretimin e dokumentacionit të paraqitur por edhe në atë çfarë ka dorëzuar dhe në përmbajtjen e këtij dokumentacioni, përmbajtje e cila nuk merret e vlerësuar veçmas nga përmbajtja e dokumentacionit të operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës. Pra kemi një vlerësim dhe një pikëzim jo të veçuar dhe absolut por relativ, të lidhur ngushtë dhe të bazuar në çfarë kanë dorëzuar operatorët e tjerë ekonomikë. Pra është marrë parasysh jo vetëm interpretimi i dokumentacionit por edhe korelacioni ndërmjet përmbajtjes së dosjeve nga secili prej operatorëve.

Autoriteti kontraktor përfshin në vlerësim specialistë të fushës të cilët vlerësojnë, përveç treguesve të tjerë, edhe kontratat e ngjashme e kualifikimet e stafit kryesor të propozuar për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, duke qënë se kontratat e konsulencës” janë kontrata të një natyre intelektuale dhe këshilluese dhe ndryshojnë nga llojet e tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë, vlerësimi i bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është kryer për secilin ofertues, në përputhje me dokumentacionin e paraqitur prej tyre dhe legjislacionin e prokurimit publik. Diferencat në vlerësimin teknik

midis ofertuesve vjen si pasojë e vlerësimit me pikë më të larta të një oferte, e cila është konsideruar më cilësore për sa i përket përvojës së mëparshme dhe stafit për përvojën dhe kualifikimet e tij, bazuar jo vetëm në dokumentacionin e paraqitur prej tyre, por edhe përmbajtjen e tij si nga ana sasiore ashtu edhe ajo cilësore.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “InfraTransportProject” sh.p.k si përfaqësues i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “InfraTransportProject” & “SDC” & “Hazbiu Project” për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence” me objekt: “Shërbime projektimi dhe mbikqyrje punimesh për projekte të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve”, me fond limit 20.833.333 lekë (pa TVSH), faza e parë e të cilit është zhvilluar në datën 20.03.2015, nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë procedurën e prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 982 Protokoli,

Datë 27.05.2015

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Zv/Kryetar
Spiro Kuro**

**Anëtar
Juliana Hoxha**

**Anëtar
Leonard Gremshi**

**Anëtar
Hektor Balluku**

**Kryetar
Gentian Këri**